

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
<b>Universiteti:</b>	<b>Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj</b>
<b>Njësia akademike:</b>	<b>Fakulteti i Inxhinierisë dhe Informatikës</b>
<b>Programi:</b>	<b>Informatikë e Aplikuar</b>
<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>Shkathtësi Komunikuese</b>
<b>Niveli:</b>	<b>Bachelor</b>
<b>Statusi lëndës:</b>	<b>Obligative</b>
<b>Viti i studimeve:</b>	<b>I, Semestri I</b>
<b>Numri i orëve në javë:</b>	<b>3</b>
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	<b>5</b>
<b>Koha / lokacioni:</b>	
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	
<b>Detajet kontaktuese:</b>	<a href="#">_____</a>
<b>Përshkrimi i lëndës:</b>	<i>Lënda ka të bëjë me mësimin dhe praktikën e të shkruarit, komunikimit; me shkrimin, leximin dhe analizimin e punimeve të studentëve. Studentët do të nxiten t'i publikojnë shkrimet e tyre profesionale në media të shkruara, me qëllim të përplotësimit të kërkesave themelore të lëndës, përkatësisht përplotësimit të realizimit praktik të mënyrës së shkrimit. Ata do të nxiten të komunikojnë dhe të zhvillojnë komunikimin në mënyrë sa më efektive.</i>
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	<i>Qëllimi kryesor i lëndës është njohja e studentëve me kulturën e shkrimit, si dhe njohja me nocionet thelbësore të shkrimit. Qëllim tjetër është zhvillimi i aftësive të studentëve për të komunikuar në mënyrë efektive në çdo situatë që lidhet me aktivitetin e tyre profesional.</i>
<b>Rezultatet e pritura të mësimnxënies:</b>	<i>Pas përfundimit të ligjëratave pritet që studentët:</i> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të kenë marrë njohuritë e duhura në fushën e komunikimit;</li> <li>• Të demonstrojnë shkathtësi në procesin e të shkruarit: gjenerimit të ideve, përgatitjen e drafteve, rishikimin dhe ripunimin e punimeve dhe në prezantim.</li> <li>• Të shkruajnë drejt dhe sipas normave të kodifikuara fjalët dhe trajtat e ndryshme të tyre;</li> <li>• Të kuptojnë rëndësinë e komunikimit në kontekstin organizativ bashkëkohor.</li> <li>• Të aftësohen për zgjedhjen e mjeteve të përshtatshme komunikuese, në varësi të situatave konkrete në biznes.</li> <li>• Të vlerësojnë format e komunikimit që mundësojnë performancë të lartë të punës në grup.</li> </ul>
<b>Parakushtet:</b>	<i>Njohuri të gjuhës shqipe, aftësi të mira të shkruarit dhe leximit, njohuri të përgjithshme të kulturës së shkrimit, dhe aftësi për të komunikuar efektivisht në gjuhën shqipe.</i>

<b>Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Aktiviteti</b>	<b>Aktiviteti</b>	<b>Aktiviteti</b>
Mësim teorik dhe praktik	3	15	45
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet			
Ushtrime në teren			
Kollokviume, seminare dhe projektet	3	2	6
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanëk të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	15	45
Përgatitja përfundimtare për provim	7	2	14
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz dhe provim final)			
Projektet dhe prezantimet	3	5	15
<b>Totali</b>			<b>125</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	<p><i>Ligjërata (forma e kombinuar – interaktive)</i>  <i>Ushtrime (hartimi i punimeve shkencore, diskutimi i tyre në grupe dhe komunikimi interaktiv, lidhur me punimet e studentëve)</i>  <i>Diskutime, debate rreth temave të ligjëruara,</i>  <i>Shkrim, interpretim</i>  <i>Verifikim i dijes përmes testimit, nëpërmjet shkrimit të eseve, seminareve.</i></p>		
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	<p><i>Studenti mund të zgjedhë të vlerësohet një nga dy format e vlerësimit, të dhëna më poshtë:</i>  <i>1. Forma 1: Vlerësim me kolokviume</i>  <i>2. Forma 2: Vlerësimi me provimin përfundimtar.</i></p> <p><b>Forma 1:</b>  <i>Në formën e parë të vlerësimit “Vlerësimi me kolokviume” studenti vlerësohet në tre veprimtari që realizohen gjatë ligjëratave:</i>  <i>1. Kolokviumi 1 (45%), vlerësim individual</i>  <i>2. Kolokviumi 2 (45%), vlerësim individual</i>  <i>3. Veprimtaria në klasë (10%), vlerësim individual</i>  <i>Nëse studentin nuk është i kënaqur me vlerësimin e arritur sipas formës 1, atëherë ai mund t'i nënshtrohet vlerësimit sipas formës 2 për të marrë një vlerësim më të lartë.</i></p> <p><b>Forma 2:</b>  <i>Nëpërmjet provimit përfundimtar studentin mund të arrijë maksimumin 90% të pikëve nga gjithsej 100 pikë.</i></p>		

	<p><i>Pjesa tjetër e pikëve prej 10% duhet të plotësohet nga aktiviteti i kryer gjatë leksioneve.</i></p> <p><i>Në Kolokviumin 1, Kolokviumin 2 dhe provimin përfundimtar, vlerësimi i studentëve do të bëhet përmes një formulari vlerësimi, i cili duhet të plotësohet individualisht nga studenti. Formulari i vlerësimit do të përmbajë 5 detyra përmes të cilave do të vlerësohen rezultatet e të nxënit të studentit.</i></p> <p><i>Aktiviteti në klasë nënkupton angazhimin e studentit në trajtimin e çështjeve të diskutuara në klasë, gjatë ligjëratave.</i></p> <p><i>Vlerësimi:</i></p> <p><i>91-100 pikë – nota 10 (dhjetë)</i>  <i>81-90 pikë – nota 9 (nëntë)</i>  <i>71-80 pikë – nota 8 (tetë)</i>  <i>61-70 pikë – nota 7 (shtatë)</i>  <i>51-60 pikë – nota 6 (gjashtë)</i>  <i>0-50 pikë – Studenti përsërit provimin</i></p>
<b>Raporti i teorisë dhe praktikës:</b>	<i>60% teori dhe ushtrime me 40% pune laboratorike</i>
<b>Literatura</b>	
<b>Literatura bazë:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li><i>1. Buisness Communication Today, Bovee/Till, ninth edition.</i></li> <li><i>2. Gjovalin Shkurtaç, Si të shkruajmë shqip, Morava, Tiranë, 2013.</i></li> <li><i>3. Sylvian Barnet, Pat Bellanca, Marica Stubbs, Shkrimi akademik, Dita, Tiranë, 2000.</i></li> </ol>
<b>Literatura shtesë:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li><i>1. Andri Koxhaj, Florian Tomini, “Manaxhimi i komunikimit”, Tiranë, 2006.</i></li> <li><i>2. S. I. Hayakawa Language in Thought And Action, 1949.</i></li> <li><i>3. Rami Memushaj, Shqipja standarde, Toena, Tiranë, 2004.</i></li> </ol>
<b>Plani i dizajnuar i mësimit</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjërata që do të zhvillohet</b>
<b>Java e parë:</b>	<i>Njohja me përshkrimin e lëndës, metodat, vlerësimin, burimet dhe literaturën.</i>
<b>Java e dytë:</b>	<i>Nocionet themelore: gjuha; shkrimi; leximi kritik; shkrimi akademik; drejtshkrimi; drejtshqiptimi</i>
<b>Java e tretë:</b>	<i>Kuptimi dhe rëndësia e komunikimit</i>
<b>Java e katërt:</b>	<i>Kultura e komunikimit</i>
<b>Java e pestë:</b>	<i>Kodet e komunikimit dhe kuptimi i tyre; parimet e komunikimit efektiv</i>
<b>Java e gjashtë:</b>	<i>Procesi i punimit kërkimor: zgjedhja e temës; përzgjedhja e literaturës dhe shfrytëzimi i burimeve; hartimi i temës Vlerësimi i parë: rezultatet e esesë tematike</i>

<b>Java e shtatë:</b>	<i>Struktura e punimit kërkimor (seminari, diploma, magjistratura, doktorata): hyrja; tema (ndarja në kapituj), përfundimi, burimet dhe literatura</i>
<b>Java e tetë:</b>	<i>Vlerësimi i esesë Vlerësimi i strukturës së punimit shkencor</i>
<b>Java e nëntë:</b>	<i>Citimi (llojet, mënyrat, format); fusnota (llojet, format)</i>
<b>Java e dhjetë:</b>	<i>Burimet dhe literatura (literatura bazë, literatura ndihmëse); bibliografia; aspektet teknike të punimit kërkimor</i>
<b>Java e njëmbëdhjetë:</b>	<i>Shkrimi i një recensionit për një libër nga drejtimi përkatës</i>
<b>Java e dymbëdhjetë:</b>	<i>Lektura, korrektura dhe redaktimi</i>
<b>Java e trembëdhjetë:</b>	<i>Komunikimi në publik</i>
<b>Java e katërbëdhjetë:</b>	<i>Vlerësimi i esesë dhe recensionit</i>
<b>Java e pesëmbëdhjetë:</b>	<i>Rekapitullimi i çështjeve kryesore të shkathësive të komunikimit</i>
<b>Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes</b>	
<i>Vijueshmëria e rregullt, mbajtja e qetësisë dhe angazhimi aktiv në dialog gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve është e obligueshme.</i>	